

Melisa Foriq

Atentati i Sarajevës





Pyetja kyçe

- A duhet atentati i Sarajevës të konsiderohet akt heroik ose krim? A mund të arsyetohet atentati me arsye patriotike?

- Monument i cilit lloj duhet ta shënojnë atentatin Sarajevës?



Tema

Ky modul flet për atentatin e Sarajevës, ngjarje e cila e shënoi fillimin e Luftës së Parë Botërore dhe e cila përmendet anekënd Evropës. Kontroversa kryesore e kësaj teme është që është paraqitur ndryshe në tekstet mësimore në regjion dhe brenda vet Bosnjës dhe Hercegovinës. Për disa prej tyre, atentatorët janë paraqitur si heronj, ndërsa për të tjetër janë paraqitur si terroristë të cilët e kanë iniciuar krizën e cila solli deri te lufta.



Ishodi

- Steçi znanje o Sarajevskom atentatu, njegovim uzrocima i posljedicama, na osnovu različitih perspektiva.
 - Sposobnost postavljanja jasnih historijskih pitanja; kritička upotreba historijskih izvora, historijskih tumačenja (interpretacija) i perspektiva, neki su od ključnih elemenata za razumijevanje pojedinih aspekata Sarajevskog atentata.
 - Učenici će ocijeniti historijske izvore u smislu pouzdanosti i različitosti perspektive.
 - Učenici će razviti vještine empatije.
-



Qëllimet

Qëllimi i kësaj punëtorie është që të sigurohet qasje multiperspektive në temën e dhënë, të shihet mendimi i atentatorit dhe qëndrimi i Qeverisë. Nxënësit do të duhet të mësojnë diçka më tepër për idetë të cilat e kanë detyruar atentatorin ta bëjë veprën e tillë dhe të shohin cilat kanë qenë pasojat e atij akti. Qëllimi i punëtorisë është t'i hapë pyetjet për veprat e kryera në emër të patriotizmit dhe për arsyetimin e tyre. Mund të zbatohet në temat bashkëkohore, të lidhura për sulmet terroriste anekënd botës.

Udhëzime për mësuesin

Aktiviteti i klasës – pjesa 1

Pjesa e parë e punëtorisë ka për qëllim të bëhet si simulim i gjykimit.

Klasa duhet të ndahet në tre grupe:

1. Prokuroria
2. Mbrojtja
3. Juria

Mësimdhënësi do të merr rolin e gjykatësit.

Juria duhet të përbëhet nga një grup i madh i nxënësve (gjysma e klasës), sepse ky grup i pranon të gjitha burimet të Grupit 1 dhe 2.

HAPI 1.

Fjalët e gjykatësit – Në fillim të orës mësuesi (gjykatësi) e bën hyrjen në temë, duke dhënë udhëzimet themelore: çka, ku dhe kur? Mësimdhënësi e shfrytëzon tekstin hyrës për pjesën hyrëse .

HAPI 2.

Punë paralele në grupe – Secili prej tre grupeve e merr pjesën e vet të burimeve. Grupi 1 (prokuroria) dhe Grupi 2 (mbrojtja) duhet t'i analizojnë në mënyrë kritike burimet e tyre, të gjejnë argumente që të përgjigjen në pyetjen kyçe për konstatimin e tyre dhe ta organizojnë prezantimin e tyre si prokurori, përkatësisht mbrojtje. Grupi 3 (juria) do t'i fitojë të përziera burimet e grupit 1 dhe 2, me detyrë që t'i kontrollojë dhe t'i ndajë sipas vlerësimit personal, cilat prej burimeve ti takojnë prokurorisë, e cilat t'i shfrytëzojë mbrojtja.

HAPI 3

Prezantim grupor – Grupi 1 dhe Grupi 2 e prezantojnë mendimin e tyre dhe përfundimet në bazë të argumenteve të mbështetura në burimet e analizuara. Grupet duhet ta prezantojnë përgjigjen e tyre në pyetjet kyçe.

Grupi 3 duhet me kujdes t'i ndjekë prezantimet që të mund t'i vlerësojë cili grup e ka bërë analizën, argumentimin dhe prezantimin më të mirë, cili grup i ka shfrytëzuar burimet e tyre. Në bazë të prezantimit, juria do ta sjellë vendimin dhe do ta paraqesë (vendimin final). Juria do ta prezantojë mendimin e vet duke u mbështetur në parim në prezantimet që do t'i dëgjojë, ndërsa të gjitha burimet të cilat i janë dhënë jurisë shërbejnë që të përfundojnë cila palë (prokuroria apo mbrojtja) kanë pasur prezantim më të mirë dhe të sjellin vendim – përgjigje në pyetjen kyç

HAPI 4

Përfundim dhe diskutim – Mësimdhënësi dhe nxënësit do t'i japin përfundimet përmbyllëse për çështjen e përgjithshme të atentatit dhe pasojat dhe ndikimet e tij më të gjerë.

Aktiviteti i klasës – pjesa 2

HAPI 1. Nxënësit fitojnë burime për ngritjen dhe mënjanimin e përmendoreve në vendin e atentatit gjatë shek. XX. Për detyrë shtëpie, nxënësit duhet t'i analizojnë burimet dhe të japin elaborat propozues me argumente konkrete të mbështetura në burime, për përmendoren e cila sot duhet ta shënojë vendin e atentatit në Sarajevë.

HAPI 2. Prezantimi i propozimit dhe zgjidhjes për përmendore në vendin e atentatit në Sarajevë, me argumentim.

HAPI 3.

Diskutim për propozimet e ndryshme dhe rolin e përmendores në jetën e përditshme.



90
minuta

Fjala e gjykatësit

Në fillim të orës gjykatësi (mësimdhënësi) bën hyrje për nxënësit – kontekstualizim për temën, faktet kryesore: çka, ku dhe kur? (në bazë zë burimeve vijuese).

Hyrije

Pas krizës së aneksimit të shkaktuar nga bashkëngjitja e territorit të Bosnjës dhe Hercegovinës ndaj Austro-Hungarisë (1908-1909) dhe Luftërave Ballkanike (1912-1913) në mënyrë të veçantë u acaruan raportet mes Serbisë dhe Malit të Zi nga njëra anë dhe Austro – Hungarisë nga ana tjetër. Austro – Hungaria me aneksimin e Bosnjës dhe Hercegovinës depërtoi thellë në Ballkan duke u kufizuar me Serbinë e cila në Luftërat e përmendura Ballkanike në mënyrë të dukshme e zmadhoi territorin e saj. Ngjarjet në Ballkanin e atyre viteve me kujdes i ndiqnin fuqitë ndërkombëtare botërore në luftën e ashpërsuar për ndarjen e botës, mes të cilave theksoheshin Austro – Hungaria, Gjermania dhe Italia, nga njëra anë, dhe Franca, Britania e Madhe dhe Rusia në anën tjetër, duke u përfshirë në intervenimet diplomatike dhe duke u përgatitur për konflikt të mundshëm të armatosur. Njëkohësisht me këto ngjarje, në vendet e sllavëve të jugut forcohen lëvizjet rinore të cilat në rend të parë e përfaqësojnë idenë e jugosllavizimit me qëllim të rrënimit të monarkisë Habsburge dhe bashkimin e të gjithë sllavëve të jugut në shtet të përbashkët nën udhëheqjen e Serbisë. Puna e rinisë zhvillohej me anë të qarqeve dhe organizatave të fshehta, ndërsa si armë e veprimit ishin edhe atentatet e përfaqësuesve të njohur të pushtetit të monarkisë. Në kushtet e raporteve të acaruar monarkia austro – hungareze në shenjë të demonstrimit të forcës së saj në Ballkan në verë të vitit 1914 organizoi manovra ushtarake të cilat i parapriu personalisht trashëgimtari i fronit arqiduka Franc Ferdinand. Gjatë vizitës së Franc Ferdinandit në Sarajevë më 28.6.1914 anëtarët e organizatës rinore Bosnja e Re në të cilën ishin Gavrillo Principi, Nedeljko Çabrinoviq, Trifko Grabez, Vaso Çubrillovq, Cvjetko Popoviq, Muhamed Mehmedbashiq, Danilo Iliq etj, e organizuan dhe e kryen atentatin ndaj trashëgimtarit të fronit, duke e vrarë gjatë kësaj edhe gruan e tij Sofinë. Për këtë ngjarje Austro – Hungaria e fajësoi Serbinë, ndërsa pas pak kohe ajo i shpalli edhe luftë. Pas kësaj vijoi përfshirja dhe shpallja e luftës edhe nga ana e shteteve të tjera evropiane. Shkëndija e ndezur me kryerjen e atentatit e ndezi zjarrin e madh të Luftës së Parë Botërore. Në historiografi ngjarja e atentatit të Sarajevës dhe përzierja e Serbisë janë paraqitur në forma të ndryshme, ndërsa akti i atentatit shpesh është arsyetuar me aktin e heroizmit të organizatës rinore Mlada Bosna, e cila dëshironte të çlirohet nga pushteti i huaj. Gavrillo Principi dhe atentatorët tjerë për disa ishin heronj, ndërsa për të tjetër kriminelë, akti i të cilëve u gjykua ashpër.



Burimi 2

Akti i aneksimit

DEKLARATË

Për popullin e Bosnjës dhe Hercegovinës
Franc Jozefi i Parë,
PËR QYTETARËT E BOSNJËS DHE
HERCEGOVINËS

Në kohën e një gjenerate më parë, kur ushtria jonë i kaloi kufijtë e vendeve tuaja, ju dha besimi se nuk erdhën si dushmanë por si miq tuaj me vullnet të fuqishëm që t'i mënjanojnë të gjitha të këqijat të cilat e shtypnin atdheun tuaj me vite të tëra.

(...) Që ta lartësojmë Bosnjën dhe Hercegovinën në shkallë më të lartë të jetës politike, vendosa t'u ndaj të dyja vendeve institucione kushtetuese të cilat do t'u përgjigjen rrethanave të tyre dhe interesave të përbashkëta dhe në këtë mënyrë të krijojmë bazë ligjore për përfaqësim të dëshirave dhe dobisë së tyre. Le të dëgjohet fjala e juaj, kur paraprakisht vendoset për çështjet e atdheut tuaj, i cili si edhe deri tani do të ketë udhëheqje të posaçme.

(...) Për këtë arsye, e duke i pasur parasysh ato lidhje që ekzistonin në kohërat e vjetra mes të parëve tanë të shquar në fronin hungarez dhe në këto vende, Ne e zgjerojmë të drejtën e sovranitetit tonë në Bosnje dhe Hercegovinë dhe dëshirojmë që në këto toka të zbatohet rendi i trashëgimisë i cili vlen për shtëpinë Tonë.

Lëshuar në Budapest, kryeqytetin tonë mbretëror dhe kryesor, më 7 tetor 1908.

M. Arslanagi – F. Isakovi , Istorija-Povijest, 1. Razred srednjeg usmjerenog obrazovanja, Sarajevo 1991, 278

Burimi 3

Karikaturë nga gazeta franceze Le Petit Journal që e sqaron krizën e aneksimit

Le Petit Journal
Le Petit Journal 5 CENTIMES SUPPLÉMENT ILLUSTRÉ 5 CENTIMES ABONNEMENTS
CINQUÈME ANNÉE - 6 PAGES - 5 CENTIMES Le Petit Journal agricole, 5 cent. - La Mode du Petit Journal, 10 cent.
Administration : 11, rue Lafayette Le Petit Journal illustré de la Jeunesse, 10 cent.
Les manuscrits ne sont pas rendus Ce s'abonne sans frais dans tous les bureaux de poste
Dix-neuvième Année DIMANCHE 18 OCTOBRE 1908 Numéro 935

LE REVUEIL DE LA QUESTION D'ORIENT
La Bulgarie proclame son indépendance. - L'Autriche prend la Bosnie et l'Herzégovine

http://en.wikipedia.org/wiki/File:Bosnian_Crisis_1908.jpg ,
downloaded on 28.2. 2012.

PUNËTORIA
PJESA 1
punë grupore
paralele

Grupi I – Prokuroria

DETYRA KRYESORE: Mbështetur në burimet kryesore të shtypit austriak, të Bosnjës dhe ndërkombëtar, dokumenteve zyrtare. Detyra është të analizohen në mënyrë kritike, të gjenden argumente për t'u përgjigjur në pyetjen pse atentati i Sarajevës duhet të shihet si krim dhe të përgatitet prezantimi.

Dëshmia 1

Fotografi zyrtare nga albumi qeveritar i vizitës



Sarajevo Museum, Sarajevo during the Austro-Hungarian Monarchy 1914-1918, Display presentation, photo by author

Detyra për burimet

1. Renditi fotografitë sipas radhës në drejtim të rikonstruksionit të ngjarjes!
2. Analizoj fotografitë se çka shihet në to dhe çfarë atmosfere mbizotëron në momentin kur janë fotografuar?

Dëshmia 2

Një artikull i gazetës zyrtare të qeverisë vendore që botohej në Sarajevë gjatë monarkisë Austro – Hungareze për vizitën e Franc Ferdinandit në Sarajevë.

(...) Mbikëqyrësi i përgjithshëm i tërë ushtrisë austro-hungareze trashëgimtari i fronit arqiduka Franc Ferdinand sot vjen në Bosnje dhe Hercegovinë. Trashëgimtari i fronit arqiduka Franc Ferdinand me sy të zgjuar e ndjek këtë zhvillim të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Ai u vjen në vizitë jo vetëm për shkak të detyrës por edhe sepse i donë me zemër. Që ta dëshmojë këtë në mënyrë të dukshme, vjen këtu jo vetë, por me gruan e tij të bukur dukeshën Sofija.

Ndjenja të forta gëzimi dhe hareje shpërndahen nëpër Bosnje dhe Hercegovinë dhe populli përgatitet ta përdorë rastin e gëzuar që me ndjenjat e veta patriotike të dinastisë ta shprehë në mënyrë të dukshme. Edhe me këtë rast, i tërë populli i Bosnjës dhe Hercegovinës, pa dallim, me zemrat përplot gëzim dhe ekzaltim, klith me përzemërsi: Mirëserdhe, arqidukë trashëgimtar i fronit!

Sarajevski list (Dobro nam došao), br. 127, 25.juni 1914 – 12. juni (Povjesni arhiv Sarajevo)

Detyra për burimet

1. Analizo me çfarë ndjenjash e priste populli trashëgimtarin e fronit?

Dëshmia 3

Ballina të gazetave të huaja

“Arqiduka Franc Ferdinand dhe gruaja e tij dukeshja nga Hohenbergu janë vrarë gjatë vozitjes nëpër rrugët e Sarajevës, Bosnjë”.

Domenica del Corriere (Javore italiane e botuar nga vitit 1899 deri në vitin 1989), 29 korrik 1914.



<http://blog.postcardgallery.net/i/pics/nyh-06-29-1914-sarav-assassination.jpg> (New York Herald, New York daily paper published in the period 1835 to 1924), downloaded on 2 June 2013



<http://previews.agefotostock.com/previewimage/bajaage/510b7d637895591db19d6200dd4aa0f2/DAE-11319783.jpg> downloaded on 27 Feb. 2012)

“Katastrofë në Sarajevë. Atentat ndaj arqidukës Franc Ferdinandit dhe dukeshës nga Hohenbergu me bombë dhe “Browing”. Vriten trashëgimtari i frontit dhe gruaja e tij. Dy atentate. (...) Burgosen atentatorët. Kthimi i perandorit.” Die Illustrierte Kronen Zeitung (gazeta më e madhe Austriake, që botohej që nga viti 1900), 29 qershor 1914

Trashëgimtari i frontit austriak është vrarë me gran e tij nga ana e të riut boshnjak për t'u hakmarrë për shkak të pushtimit të vendit të tij.



http://einestages.spiegel.de/hund-images/2009/11/16/96/e70e86700c4437f45762133de62765b5_image_document_large_featured_borderless.jpg, downloaded on 2 June 2013



New York Times (American daily paper published continuously since 1851), 29 July 1914, Internet, <http://blu.stb.s-msn.com/i/7B/4992F9D19CEEE63507ADD6D4C2BE2.jpg>, downloaded on 2 June 2013

Detyra për burimet

1. Si është prezantuar lajmi në gazetave të huaja?
2. Pse ky lajm shkaktoi kujdes të këtille dhe interes për botën e gjerë?

Dëshmia 4

Pjesë nga një artikull i një gazete të jashtme

POLITISCHE CORRESPONDENZ (Vjenë)

Die Ermordung der Hrofolgers und seiner Gemahlin – nr. 11610, 30 qershor 1914.

Kjo agjenci lajmesh boton çka kanë shkruar gazetat e Vjenës ditën e dytë pas atentatit.

Neue freie Presse: Atentati ishte vrasje ballkanike, vepër e etjes për gjak, e ngjashme me kasapërinë egër. Por, nëse ky atentat do të thotë që sundimtarët tanë dhe trashëgimtarët e fronit do të priten çdoherë kështu në Sarajevë, atëherë përgjigja e vetme mund të jetë: “Këtu jemi dhe këtu do të mbetemi”. Të gjithë krerët e shteteve duhet të mendojnë për paqe, por nuk guxojnë të lejojnë që infeksioni ballkanik të përhapet më tej, sepse krimet janë infektuese.

Die Zeit: Hije e rëndë bie mbi Serbi. Asaj tani i është ofruar rast i madh dhe i mirë që të bëjë mirë për veten dhe për të tjerët, por edhe për bashkëpatriotët e saj në Monarkinë tonë. Ajo duhet ta shfrytëzojë këtë rast. Pas veprës primitive serbe në Sarajevë duhet të vijë kundërvepra serbe në Beograd.

Nikola Đ. Trišić, Sarajevski atentat u svjetlu bibliografskih podataka, Veselin Masleša, Sarajevo 1980, 21.

Detyra për burimet

1. Si u prezantua ngjarja në gazetat e huaja?
2. Pse kjo ngjarje shkaktoi aq kujdes në publik anekënd botës?

Dëshmia 6

Zëri i historiografisë – HISTORIA E ATENTATIT

Zherajiq gjuajti në kreun vendor të Bosnjës dhe Hercegovinës, gjeneralin Vareshanin, që t’ua bënte me dije krerëve të Austro-Hungarisë që rinia i përbuz qëllimet e tyre për hapjen e Kuvendit (...)

Luka Jukiq u përpoq (8.6.1912) të bëjë atentat ndaj komisarit mbretëror Slavko Cuvaja, që klasës sunduese hungareze t’ia shprehë qëndrimin e rinisë nacionale që Kroacia nuk është hungareze, por kroate.

Në përcaktimin e pjesëtarit të lëvizjes jugosllave nacional-revolucionare, në radhë të parë “Mlada Bosna” (Bosnja e Re), për atentatet si metodë e luftës kundër pushtetit të huaj, çlirimit nacional dhe bashkimit, vepronin jo vetëm rrethanat e caktuara politike dhe shoqërore por edhe ndikimet shpirtërore, kulturore-politike, pa të cilat nuk mund të sqarohet fizionomia e tyre morale dhe intelektuale, figura e tyre historike.

Enver Redžić, Omladinski pokret I sarajevski atentat, Prilozi za istoriju BiH, Posebna izdanja ANUBiH, LXXIX, Odjeljenje društvenih nauka, knj. 17. Sarajevo 1987, 318-319.

Detyra për burimet

1. Pse organizoheshin atentate më parë (para Atentatit të Sarajevës)?
2. Cili ishte qëllimi i tyre?

Dëshmia 5

Artikull gazete nga Sarajevski List nr. 130, 29 qershor (16 qershor) 1914

Artikull i gazetave ditore të Qeverisë Vendore gjatë kohës së monarkisë së Austro-Hungarisë për atentatin mbi Franc Ferdinandin.

“Këto ishin ditët e gëzimit, ditët mahnitjes. Kush nuk i mban mend? (...) Populli i pranoi me gëzim, sepse kjo vizitë ishte dekorim, i përshëndeste, kur befasisht u shfaq në Sarajevë, sepse mahniteshin duke e parë sy më sy sundimtarin e tyre të ardhshëm. (...) Dhe më pas erdhën ditët e fundit të qëndrimit të tyre në Sarajevë – dhe menjëherë u mbush deri në fyt gota e gëzimit me vrerin e hidhur. Edhe gëzimi dhe hareja menjëherë u zhdukën nën përshtypjen e aktit të frikshëm, zot braktisur për shkak të së cilit ranë viktimë jetët e çmueshme të arqidukës trashëgimtar të fronit Franc Ferdinandit dhe dukeshës Sofija të Hohenburgut. (...) Mes zemrave të pikëlluara të sotme të Bosnjës shtrihet trupi i vdekur i shpresës dhe krenarisë sonë të të gjithë monarkisë habzburge. (...)”

Dëshmia 7

Dokument zyrtar për organizatën rinore nacionaliste-revolucionare në Sarajevë

TRANSKRIPTIM I QEVERISË VENDORE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS nr. 5544 Pres. Sarajevë, 9 korrik 1914.

Ekzistimi i një organizatë nacionaliste – revolucionare në Sarajevë.

Për një kohë, sipas rrethanave jo para tërë vitit, në Sarajevë ekziston një organizatë rinore e cila tingëllon në mënyrë naive, “Rinia nacionaliste serbo-kroate”.

Kjo organizatë nuk ka shfaqje të fuqishme, por ajo është në rend të parë organizatë e nxënësve të Shkollës së Mësuesisë, pastaj të nxënësve të shkollës së mesme, por ka edhe disa të rinj të shtresës së tregtarëve dhe zejtarëve.

Ajo nuk ka rregulla të posaçme as lokal të vetin. Bazën kryesore të veprimtarisë së saj e bëjnë statutet e “Bashkimit popullor” famëkeq ose gjithashtu “Uniteti Popullor” nga Beogradi, së cilës një kohë i takonte gjithashtu atentatori Zherajiq. Qëllimi dhe detyra e kësaj organizate është që e tërë rinia e Jugut sllav të kultivohet me frymën e njëjtë dhe të organizojë në kuptim të një bashkimi shtetëror jugosllav në çdo kuptim nën sundimin suprem serb, domethënë shkëputje të dukshme nga fronti habzburg (“Nga sundimi i padurueshëm habzburg”).

Qendrat e kësaj lëvizjeje janë Beogradi, Zagrebi, Lubjana dhe Sarajeva, ndërsa në të gjitha selitë e shkollave të mesme do të duhej të formoheshin gradualisht degët.

V. Bogi evi , Mlada Bosna, Sarajevu 1954.

Dëshmia 8

Fotografia e gjykimit



Muzej Sarajevu, Sarajevu u Austro-Ugarskoj 1914-1918

Detyra për burimet

Në burim gjeni vlerësimet e pushtetit për rolin dhe idetë e lëvizjes rinore dhe lidhshmërinë e tyre me atentatin.

Detyra për burimet

1. Analizoje fotografinë e atentatorëve në gjykim.
2. Çfarë emocionesh mund të dallosh në fytyrat e tyre?

Dëshmia 9

Artikull gazete: “Kujtime për rezultatet e hetimeve”

Kujtime për rezultatet e hetimeve në Sarajevë:

Hetimet të cilat gjyqi në Sarajevë i udhëhoqi ndaj Gavrillo Principit dhe shokëve për shkak të kryerjes së krimit më 15 qershor të këtij vitit dhe për shkak të bashkëpjesëmarrjes në të deri tani e përcaktoi këtë:

1. Planin që arqiduka Franc Ferdinand të vritet gjatë kohës së qëndrimit të tij në Sarajevë e përgatitën në Beograd Gavrillo Princip, Nedeljko Çabrinoviq dhe Trifko Grabezh me ndihmën e majorit Voja Tankosiq.
2. Gjashtë bombat dhe katër pistoletat Browning me municion, që atentatorët i përdorën si armë, u morën dhe iu dhanë Principit, Çabrinoviqit dhe Grabezhit në Beograd, nga njëfarë Ciganoviq dhe majori Tankosiq.
3. Bombat ishin granata dore të cilat ishin marrë nga depoja e armëve të ushtrisë serbe në Kragujevac.
4. Që të sigurohet sukcesi i atentatit Ciganoviq e mësoi Principin, Çabrinoviqin dhe Grabezhin për përdorimin e granatave dhe gjuajtjen me pistoletën Browning në një pyll afër vendit për gjuajtje të Topçiderit.
5. Që Principit, Çabrinoviqit dhe Grabezhit t'i mundësohet kalim nëpërmjet kufirit boshnjakohercegovas dhe që të mundësohet kontrabandimi i armëve të tyre, Ciganoviq organizoi një sistem të tërë të fshehtë për bartje. Hyrja e kriminelëve dhe armëve të tyre në Bosnje dhe Hercegovinë u realizua nga autoritetet kufitare të Shabacit (Rade Popoviq) dhe Lloznicës, si edhe zyrtari doganor Radivoj Grbiq nga Lloznicë me ndihmën e personave të tjerë.

Politika, br. 3769, 12. 07. 1914.

PJESA E PUNËTORISË 1

punë paralele në
grupe

Grupi II – Mbrojtja

DETYRA KRYESORE: Mbrojtja do t'i pranojë burimet nga dokumentet programore të Organizatës Rinore dhe ideologjisë së tyre, artikuj të shtypit serb dhe ndërkombëtar, letra dhe dokumente personale të atentatorit. Detyra është të analizohen në mënyrë kritike, të gjenden argumente për përgjigje ndaj pyetjeve dhe a mund të konsiderohet atentati i Sarajevës akt heroik i arsyeshëm me arsye patriotike nga këndvështrimi i tyre dhe përgatitja e argumenteve për qëndrimin e mbrojtjes.

Dëshmia 1

Letër e organizatës Mlada Bosna, që e përcakton programin e lëvizjes

BOSNJA E RE (Mlada Bosna)

Bosnja është tokë e vjetër serbe. Sipas psikologjisë së vet, kulturës, tërë jetës. Pesë shekuj robëri kanë lënë gjurmë të thellë në shpirtin e saj. Ajo ka pranuar goditje, është vrarë, ka rënë dhe është gjunjësuar, çdoherë duke mbajtur në vete një besim të madh, një instinkt të madh, të ngrohtë. Pas shumë vuajtjesh dhe rëniesh është freskuar me zemrën e saj, sërish ka filluar të jetojë, e heshtur, e ngadalshme dhe e mbërthyer. Historia e saj gjatë njëqind vjetëve të fundit është e plotë me gjak të derdhur, zjarr dhe tym. Përderisa pjesët e popullit tonë në viset tjera hynin në kulturë, duke i hequr nga vetja ata prurje barbare të robërisë, ne ishim të rrahur, mbetëm primitivë, të pa ngritur dhe të zhveshur. (...)

Lëvizja e re e Bosnjës për ripërtëritjen e vendit të tyre duhet të mbështetet në dashuri të thellë, të madhe ndaj popullit dhe besimit të madh krijues në vetvete. Asnjë forcë nuk guxon ta shuajë këtë dashuri dhe asnjë fatkeqësi nuk guxon ta luhatë këtë besim. Kështu, me punë të ngadalshme dhe të vogël, do të kryhet procesi më i madh në jetën e popujve, çlirimi i tij nga errësira dhe ngritja e tij nga liria shpirtërore dhe pavarësia morale. Vendi ynë i ri, i thyer dhe i përvuajtur, i robëruar dhe plot errësirë, mund vetëm të nisët drejt asaj rruge. Në gjendje të krizave shpirtërore dhe ekonomike, ajo ngjitet në diellin e ri, mban besim të ri dhe krijon jetë të re. Ajo që i jepet është vetëm një kontribut i ripërtëritjes së saj, Ringjalljes së saj të madhe që vjen...

Vladimir Gaćinović, *Calendar Prosvjeta, Sarajevo, 1911, 92-94, in: V. Bogičević, Mlada Bosna, pisma i Prilozi, Sarajevo 1954.*

Detyra për burimet

Gjeji në tekst cilat ishin qëllimet dhe parimet udhëheqëse të anëtarëve të Mlada Bosna.

Dëshmia 2

Shënime stenografike, Gavrillo Principi për bindjet e tija politike

GAVRILO PRINCIP PËR QËLLIMET E TIJA POLITIKE DHE TË ORGANIZATËS MLADA BOSNA

Ideali i rinisë: Bashkimi i popujve jugosllavë serbëve, kroatëve dhe slovenëve, por jo nën Austrinë. Në një formë shtetërore, në republikë, ose të ngjashme. Mendonte se do të shpërthejë revolucion nëse Austria bie në një gjendje të vështirë. Për revolucion të tillë duhet të përgatitet tereni, të krijohet disponimi. Edhe më parë kanë ekzistuar atentatet, atentatorët kanë qenë heronj për rininë tonë. Nuk ka menduar të bëhet hero. U mundua vetëm të vdesë për idenë e tij. (...)

Dr Martin Papenhajm; Princip o sebi, Zagreb 1926), in: V. Bogičević, Mlada Bosna, pisma i Prilozi, Sarajevo 1954, 464-465.

Detyra për burimet

Në tekst gjeni çka synonin dhe çka i udhëhiqte pjesëtarët e organizatës Mlada Bosna?

Dëshmia 3

Pamflet i përkrahësve të atentatorëve

Le t'i duam heronjtë tanë: Jukiqin, Zerajiqin, Doçiqin, Çabrinjin, Planinshçakun, Principin, sepse ata janë profetët e kombit, sepse ata janë kombi! Bijtë e Jugosllavisë së vetme!

A nuk e ndjeni, bijtë e Jugosllavisë së vetme, se në gjak shtrihet jeta jonë dhe se atentati është Zoti i Zotave të Kombeve, se ai dëshmon se është gjallë Mlada Bosna. Se jeton elementi të cilin e shtyp barra e padurueshme imperialiste, se jeton elementi i cili është i gatshëm të vdesë!

(...) Në gjak është jeta e racës, në gjak është Zoti i kombeve. Vdekja i paraprinte Ringjalljes! Atentati është Ringjallja e Kombit. (...) dhe vdekja e dy heronjve të saj është Ringjallje e zemrave tona.

O bij profetë të ndritur, të mëdhenj të Jugosllavisë!
MANUSKRIP I gjetur gjatë kërkimit të vendit të Mladen Stojanoviqit, student i vitit të fundit në gjimnazin e Tuzllës, të cilin ai e shkroi në ditën e atentatit të Sarajevës, 28 qershor 1914;

V. Bogičević, Mlada Bosna, Sarajevo 1954.

Detyra për burimet

Çfarë argumenti për mbrojtjen mund të nxirret nga tekstet e theksuara?

Dëshmia 4

Shënime stenografike nga dëshmia e Gavrillo Principit

Gavrillo Principi

Kryesuesi: Çfarë mendimi keni?

I akuzuari: Unë jam nacionalist jugosllav dhe synoj bashkimin e jugosllavëve në cilëndo qoftë forme shtetërore, të çlirohen nga Austria (69).

Kr.: Cili ishte mendimi për Austrinë në qarqet tuaja?

I ak.: Mendimi ishte se Austria është krim në popullin tonë, siç është faktikisht, edhe se nuk është e nevojshme (70).

Kr.: Cili ishte mendimi sa i përket Serbisë, a do të ishte për Bosnjën e dobishme t'i bashkëngjitet Serbisë?

I ak.: Kishte mendim që të bashkohen jugosllavët. Kuptohet, Serbia si pjesë e lirë e jugosllavëve, kishte obligim moral ta ndihmojë këtë bashkim, të jetë siç ishte Piemonti në Itali (70).

Kr.: Çfarë mendimi kishte Iliçi në aspektin politik?

I ak.: Ai është nacionalist si edhe unë, jugosllaven.

Kr.: Domethënë i të njëjtit mendim si edhe ju?

I ak.: Po, që të bashkohen jugosllavët.

Kr.: Nën Austrinë?

I ak.: Zot na ruaj! Unë nuk isha për dinasti. Aq larg nuk shkuam, por mendonim: bashkim, si do që të jenë rrethanat (81).

Mbrojtësi, dr. Premuzhiq: A besoni ju në Zot apo jeni ateist?

I ak.: Ateist (105).

Bilješke iz stenograma sa procesa protiv zavjerenika u Sarajevskom atentatu 1914 g.) DAS, akv. br. 828. u: V. Bogičević, Mlada Bosna, Sarajevo 1954..

Dëshmia 5

Shënime stenografike për dëshminë e Nedeljko Çabrinoviqit

Nedeljko Çabrinoviq

Kryesuesi: A keni qenë ndonjëherë nacionalist?

Akuzuari: Po, por i kam ruajtur idetë e mia anarkiste.

Kr.: A ishin edhe të tjerët të tillë?

I ak.: Të tjerët ishin radikalë nacionalistë.

Kr.: Çka do të thotë kjo nacionalistë radikalë?

I ak.: Bashkimin e të gjithë serbëve në një kurorë. Vendosija e perandorisë së vjetër të Dushanit.

Kr.: Nën Austrinë?

I ak.: Jo.

Kr.: Cili ishte qëllimi që të realizohet kjo?

I ak.: Lufta kundër Austrisë për shkëputjen e Bosnjës dhe Hercegovinës, Sremit dhe Banatit.

Kr.: A pajtoheshit ju me vështirimet e tyre?

I ak.: Ideali im ishte një republikë jugosllave, përgjithësisht republikë sllave.

Kr.: Si mendoni ju se si mund të realizohet kjo?

I ak.: Kjo është e pamundur me mënyrë legale.

Kr.: Si mund të bëhet kjo, në Serbi ka një dinasti, a është e adhuruar?

I ak.: Po.

Kr.: Si e imagjinoni këtë mendim tuajin?

I ak.: Mendoj se kjo mund të arrihet me organizatë siç zbatoi Macini në Itali. Por, meqë serbët dhe të gjithë ata mes së cilëve kam lëvizur kishte ideal shkëputjen e Bosnjës nga Austria, dhe bashkëngjitjen Serbisë, për këtë pajtoheshim. Ishim të ndarë për atë që ata ishin ithtarë të dinastisë nën kurorën e Karagjorgjeviqit, ndërsa unë deri në fund u mbeta besnik ideve anarkiste. Kisha mundësi të ndryshoj vetëm aq sa të mundesha t'u lejoj atyre si një farë kompromisi që ajo dinasti, ose nëse është e mundur, vetë mbreti Petar derisa është gjallë të mbetet mbret, ndërsa pas vdekjes së tij të krijohet republika jugosllave (27, 28).

Kr.: Çili është përcaktimi yt fetar, a je deist apo ateist?

I ak.: Ateist (39)

Bilješke iz stenograma sa procesa protiv zavjerenika u Sarajevskom atentatu 1914 g.) DAS, akv. br. 828. u: V. Bogičević, Mlada Bosna, Sarajevo 1954.

Detyra për burimet

Cilat ide dhe ndjenja mbizotërojnë në përgjigjet e Gavrillo Principit në shënime stenografike?
Dëshmia 5

Detyrat për burimet

Çfarë fliste Nedeljko Çabrinoviq për qëllimet dhe ndjenjat personale në shënime stenografike?

Dëshmia 6

Artikulli i gazetës *Politika*, *Biblioteka Popullore e Serbisë*, *Katalogu Online*

Ngjarja e përgjakshme e Sarajevës në Beograd shkaktoi përshtypje të thellë në të gjitha shtresat e shoqërisë. Kjo përshtypje është aq e mëdha që të gjithë ne që nga përvoja e dimë se si përgjigje ndaj kësaj vepre të përgjakshme do të vijmë një sërë fatkeqësish për popullin tonë në monarkinë Austro-Hungareze. (...)


Sipas traditës së tyre të vjetër, shtypi i Vjenës së rish do të hedh akuza kundër popullit serb dhe Serbisë. Populli serb do të jetë fajtor për atë që atentatorët Çabrinoviq dhe Princip janë serbë për nga kombësia. Serbia do të jetë fajtoare sepse njëri prej atyre atentatorëve, siç lajmërojnë telegramet nga Sarajeva, deklaroi gjatë hetimit se ka qenë në Beograd më herët. Ndërsa edhe njëra akuzë edhe tjetra janë absurde. As i tërë populli mund të jetë përgjegjës për veprën e njërit apo individit tjetër, as Serbia mund të jetë përgjegjëse për veprat e ndonjë njeriu sepse ai ka jetuar në Serbi. (...)

Politika, br. 3744, 17. lipnja 1914.
Narodna biblioteka Srbije, On line katalog

GJYKIMI NË SARAJEVË

Filloi gjykimi i Principit, Çabrinoviqit dhe shokëve për shkak të vrasjes së Franc Ferdinandit dhe gruas së tij. Prokurori shtetëror i gjyqit të Sarajevës e akuzon Principin dhe edhe njëzetedy shokë të tij për tradhti të lartë, dy vrasje me paramendim. Krahas tyre edhe tre të tjerë akuzohen për bashkëpjesëmarrje në fshehjen e armëve të cilat janë furnizuar që me ato të kryhet atentati. Në aktakuzë prezantohet procedura e komplotit të thurur në Beograd nga anëtarët e Mbrojtjes Popullore dhe përshkruhet udhëtimi i komplotistëve dhe kontrabandimi i armëve në Bosnje, mënyrën me të cilën komplotistët arritën të gjejnë bashkëpjesëmarrës në Sarajevë dhe të dhëna të tjera rreth atentatit. Duke i theksuar motivet e atentatit, cila është ngjarja politike e rendit të parë, aktakuza e përshkruan veprimin irredentist të qarqeve serbomëdha në Beograd të cilat arrijnë deri te vet oborri dhe puna sistematike kundër dinastisë Austro-Hungareze dhe Habzburge në Servbi, Kroacia dhe Bosnje, punë e cila të vetmin qëllim e ka pasur që Austro-Hungarisë t'i shkëputet Kroacia, Dalmacia, Istra, Bosnja, Hercegovina dhe provincat në jug të Hungarisë, të banuara me serbë, dhe ata vise të bashkohen me Serbinë. Komplotistët Princip dhe Çabrinoviq pranuan se siç pohohet në një telegram nga Sarajeva, që ishin të inspiruar me urrejtje ndaj Monarkisë dhe ndjenjave nacionaliste serbomëdha të cilat synojnë bashkimin e të gjithë jugosllavëve, shkatërrimin e Austro-Hungarisë dhe krijimin e perandorisë së madhe serbe. Për shkak të kësaj, ata kanë bërë plan për atentat ndaj jetës së arqdukës Franc Ferdinand, plan të cilin edhe e kanë realizuar.

Politika, br. 3842, 6. 10. 1914,
Narodna biblioteka Srbije, On line katalog



TË GJITHË QAJNË

Një skenë gjyqësore e përgatitur sipas zhanrit vjenez. Vjenë, 15 tetor.

Në fund të procesit të Sarajevës Çabrinoviq e mbaroi rrëfimin e tij me fjalët: “Vërtetë nuk e dinim që i vdekuri ishte baba, që ka fëmijë, këtë e kuptuam këtu. Jemi të tronditur deri në fund të shpirtit me fjalët e tija të fundit që ia tha gruas të tij: Mos vdis! Jeto për fëmijët e tu (e tërë salla e gjyqit qan). Mund të thuhet që jam keqbërës, vrasës. Bëni me mua ç’të doni, por betohem në Zot, vetëm dua që perandori i vjetër, që fëmijët, në shpirtat e tyre, të na falin sepse ne kemi gabuar ndaj tyre. Ju, gjykatës, na dërgoni menjëherë në vdekje. Nuk jemi keqbërës të thjeshtë, vetëm djelmosha të mashtruar.”

Më tej nuk mundte të flas nga qarja. Më pas kryetari u kthye drejt të akuzuarve dhe i pyeti a dëshiron të flasë edhe dikush? Atëherë fuqishëm dhe vendosmërisht u çua Gavrillo Principi (...) me faqe të turpëruara, por i përmbajtur që të shihet si sundon me forcën e tij, zëri ishte energjik dhe deklaroi: “Nuk kishte ndikime të jashtme në këtë atentat. Kur flet ndryshe këtu Çabrinoviqi, ai gënjen, ndërsa gënjen edhe prokurori publik, i cili dëshiron ta dëshmojë këtë. Neve askush nuk na ka huazuar! E donim popullin tonë, i njihim rrethanat në të cilat gjendet, i dinim të gjitha brengat e tij! Kjo është e vërtetë.”

“Gavrillo Princip, student i vitit të fundit të Gjymnazit, vrau në Ditën e Shën Vidit në Sarajevë trashëgimtarin e fronit Austro-Hungarez Franc Ferdinandin dhe gruan e tij, dukeshën Sofia Hohenberg”, *Politika*, 6 korrik 1914 – e vetmja fotografi e publikuar në *Politika* në vitin 1914

(koment në: Nikola . Tri i , *Sarajevski atentatu svjetlu bibliografskih podataka*, VeselinMasle a, Sarajevo 1980)



Detyra për burimet

1. Si raportonte shtypi serb për atentatorët dhe gjykimin e tyre?
2. Cilat argumente për mbrojtje mund të nxirren nga tekstet e theksuara?
3. Si mund të sqarohet arsyeja pse është fotografia e Gavrillo Principit e vetmja fotografi e botuar në gazetën “Politika” në vitin 1914?

Cila është detyra?

Përgjigja ndaj pyetjes:

Çfarë lloj monumenti duhet ta shënojë atentatin e Sarajevës?

Nxënësit pranojnë burime për vendosjen dhe heqjen e përmendores nga vendi i atentatit gjatë shek. XX. Për detyrë shtëpie, nxënësit duhet t'i analizojnë burimet dhe të japin elaborat propozues me argumente konkrete të mbështetura në burime, për përmendoren e cila sot duhet ta shënojë vendin e atentatit në Sarajevë.

HYRJE

Ngjarjet që i kanë shënuar momentet e caktuara të historisë janë shënuar jo vetëm në dokumente, libra dhe kujtime por edhe në vendet ku ato kanë ndodhur ngrihen përmendore. Vendi ku ndodhi atentati i Sarajevës është një ri prej vendeve i cili synohej të ruhej nga harresa me ngritjen e përmendores e cila gjeneratave më pas do t'u flasë për ngjarjet të cilat ndodhën këtu më 28 qershor 1914.

Sot, njëqind vjet pas atentatit, mund të flasim për përmendoret që janë ndryshuar në lidhje me ideologjinë e sundimitarit dhe formës politike në kuadër të së cilës është gjendur Bosnja dhe Hercegovina dhe Sarajeva gjatë historisë së saj.

Në vitin 1917 në urën Latine, në vendin e vrasjes autoritetet Austro – Hungareze ngritën monument për arqidukën Franc Ferdinand dhe gruan e tij Sofinë, të titulluar "Përmendore për vrasjen". Pas krijimit të Mbretërisë së SKS (1918) mënjanimi i përmendores që e madhëron monarkinë Habzburge u bë prioritet i pushtetit të ri, dhe në mars të vitit 1919 kjo përmendore u hoq. Në vendin e atentatit më pas është vendosur pllaka përkujtimore për Gavrillo Principin dhe atentatorët. Paralelisht me këtë në varrezat pranë kishës së Shën Arhangjelit Mihailit në Koshevë të Sarajevës në vitin 1920 është ngritur varreza e përbashkët e atentatorëve në të cilën janë varrosur eshtrat e tyre dhe është vënë pllakë përkujtimore. Varreza e përbashkët dhe vendi përkujtimor janë ruajtur deri në ditët e sotme. Trupat okupuese gjermane pas ardhjes në Sarajevë në vitin 1941 e mënjantuan pllakën përkujtimore të pjesëtarëve të Mlada Bosna. Pas çlirimit në vitin 1941, autoritetet e reja të Republikës Popullore të Bosnjës dhe Hercegovinës, e cila ishte pjesë e Jugosllavisë Socialiste (1945-1991) ngritën më 6 maj 1945 pllakë të re përkujtimore për anëtarët e Mlada Bosna. Jo shumë kohë më pas (1956) u vendosën gjurmët e këmbëve të Gavrillo Principit. Në vendin e atentatit u hap muzeu i Mlada Bosna (1953), ndërsa ura mbi lumin Miljacka u quajt Ura Gavrillo Princip. Pas shpalljes së pavarësisë së Bosnjës dhe Hercegovinës në vitin 1992 dhe me fillimin e luftës dhe rrethimit të Sarajevës, pllaka përkujtimore dhe gjurmët e këmbëve të Gavrillo Principit u zhvendosën. Muzeu pas mbarimit të luftës në vitin 1995 e ndryshoi emrin në Muzeu i Sarajevës 1878-1918, ndërsa u vendos pllaka e re me mbishkrimin në gjuhën boshnjake dhe angleze. Ura e dikurshme Gavrillo Princip sot e mban emrin ura Latine.

Duke i analizuar monumentet në vendin e atentatit ne mund t'i ndjekim ndryshimet e mbamendjes për atentatin e Sarajevës dhe pjesëmarrësit e tij.

Burimi 1

Fotografi dhe informata për ngritjen e përmendores së Francit dhe Sofisë në Sarajevë në vitin 1917.

"Në këtë vend arqiduka Franc Ferdinand dhe gruaja e tij Sofija i dhanë jetët e tyre dhe e derdhën gjakun për Zotin dhe atdheun".

Mbishkrimi i monumentit të vitit 1917.

Muzeu i Sarajevës



Burimi 2

Fotografi dhe informata për ndërtimin e varrezës për atentatorët më 1920.


SOT NË SARAJEVË
(TELEGRAM PËR 'POLITIKËN')

Sarajevë, 6 qershor
Nesër, në ditën e Shën Gjonit, do të zhvillohet varrimi formal i eshtrave të heronjve të Vidovdanit, Gavrillo Principit, Nedeljko Çabrinoviqit, Jakov Milloviqit, vëllezërve Mitra dhe Nega Keroviq, të cilët janë në shoqërim të Sokolave të bartur nga Terezini në Çeki.

Procesioni nisët nga posta kryesore, ku do të mbaj fjalim Lujo Novak, drejt vendit ku Gavrillo Princip e vrau Franc Ferdinandin dhe gruan e tij, në Vidovdan 1914. Në atë vend, Vasilj Grdiq do të flasë për rëndësinë e atentatit të Vidovdanit, ndërsa pastaj kori do të këndojë "Hej, njeri me bori".

Varreza e veçantë është ndërtuar në varrezat në Koshevë, ku nesër do të vendosen eshtrat e Gavrillo Principit dhe shokëve të tij.

Politika, br. 4384 od 7. juna 1920



I bekuar është ai që jeton përjetësisht.

Ka pasur arsye pse të lindë.

Heronjtë e Vodovdanit

Nedeljko Çabrinoviq

Veljko Çubriloqiq

Gavrillo Princip

Danillo Iliq

Nego Keroviq

Mihajilo Mishko Jovanoviq

Jakov Milloviq

Bogdan Zherajiq

Trifko Grabez

Mitar Keroviq

Marko Periq

1914.

Kishëza e Shën Arhangel Mihailit dhe teksti në pllakën përkujtimore të varrit, fotografia nga autori

Lajmet nga "Politika", dhe fotografitë nga Interneti

Burimi 3

Film për zhvendosjen e pllakës përkujtimore të Gavrillo Principit nga forcat gjermane në Sarajevë, 1941

(Youtube) <http://www.youtube.com/watch?v=zeHbpHye-jQ&feature=ghist&context=G23aececAHT009KAADAA>

Burimi 4

Fotografia e gjurmëve të këmbëve të Gavrillo Principit dhe pllaka e vendosur në vitin 1945



NGA KY VEND
MË 28 QERSHOR 1914
GAVRILLO PRINCIP
ME KRISMËN E TIJ
E SHPREHU PROTESTËN
KOMBËTARE KUNDËR
TIRANISË DHE SYNIMIN
SHEKULLOR TË POPUJVE
TANË PËR LIRI

Pllakë përkujtimore e vendosur më 6 maj 1945 dhe gjurmët e këmbëve të Gavrillo Principit të vendosura më 1956.

<http://g-ecx.images-amazon.com/images/G/01/wikipedia/images/b67c09a14e346968a34ce5b9ec165b8746cee8aa.jpg>

Burimi 5

Artikull gazete për vendosjen e pllakës përkujtimore në vendin e atentatit (8 maj 1945)

Shpalosja e pllakës përkujtimore të Gavrillo Principit

Si pjesë e Kongresit të Parë të Rinisë, më 7 prill në orën 16:00, tubimi i madh në parkun Perandori Dushan në Sarajevë u hap manifestimi për shpalljen e pllakës përkujtimore të heroit të madh popullorë dhe martirit, luftëtarit për liri dhe vëllazëri të të gjithë popujve të Jugosllavisë, Gavrillo Principit. (...) Pas fjalimit, është formuar kortezhi i cili shkoi deri te vendi historik, Ura e Principit, ku plumbi i Gavrillo Principit e paralajmëroi vdekjen e të gjithëve që tentojnë ta imponojnë robërinë e popullit tonë.

Pllaka e re është vendosur në vendin e njëjtë ku qëndronte edhe pllaka paraprake në kujtim të Gavrillo Principit, të cilën e hoqi armiku gjatë ditëve të para të okupimit (...) Shpalosjen e pllakës të pranishmit e përshëndetën me fjalët: "Lavdi për heroin e palodhur të popullit Gavrillo Principin dhe shokët e tij".

Oslobo enje, 8. maj 1945

Burimi 6

Fotografia e pllakës së re përkujtimore të vendosur në vitin 2002

SA OVOG MJESTA 28 JUNA 1914. GODINE
GAVRILO PRINCIP JE IZVRŠIO ATENTAT NA
AUSTROUGARSKOG PRESTOLONASLJEDNIKA
FRANCA FERDINANDA I NJEGOVU SUPRUGU
SOFIJU

FROM THIS PLACE ON 28 JUNE 1914
GAVRILO PRINCIP ASSASSINATED THE HEIR
TO THE AUSTRO-HUNGARIAN THRONE
FRANZ FERDINAND AND HIS WIFE SOFIA

Fotografia e pllakës së re përkujtimore të vendosur në vitin 2002, fotografuar nga autori.

VIDEO MATERIALE

1. Film i shkurtër për atentatin

http://www.youtube.com/watch?v=5_qvMykIN20

2. Film për zhvendosjen e pllakës përkujtimore të Gavrillo Principit nga Forcat Gjermane në Sarajevë në vitin 1941

<http://www.youtube.com/watch?v=zeHbpHye-jQ&feature=g-hist&context=G23aececAHT009KAADAA>